



**KUVENDI KOMUNAL PEJË**

**I. Numër:463-01/60545,datë: 30. Korrik 2020.**

Në bazë të dispozitave të nenit 11, dhe nenit 17 paragrafi 1 pika b) i Ligjit nr.03/L-040 për vetqeverisje lokale të Republikës së Kosovës, (Gaz.Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28, dt.04.06.2008), nenit 4 paragrafi 2. nënpika 2.4.1 të Ligjit nr.03/L-139 për shpronsimin e pronës së paluajtëshme , nenit 8 dhe nenit 14 paragrafi 1 pika b) të Statutit të Komunës së Pejës, 01.nr.09-8103 dt.29.09.2008, Kuvendi Komunal Pejë , në takimin e mbajtur 30. Korrik 2020, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, muar këtë:

**V E N D I M**

**Nr.38/2020**

**MBI SHPALLJEN E INTERESIT PUBLIK**

**I.MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës ashtu që **SHPALLET** interesi publik me qëllim të realizimit të projektit: Zgjerimi i hapsires gjelbruese te shkolles “7 shtatori” në Vitomiricë ne ngastrën kadastrale 1728/2, ZK Vitomiricë e cila ka sipërfaqen prej 200 m2 pronë në emër të Jakup Krasniqit qirambajtje per 99 vite.

Për tu realizuar një projekt i tillë, prek interesat e pronës private, prek ngastrën kadastrale 1728/2, ZK Vitomiricë e cila ka sipërfaqen prej 200 m2 pronë në emër të Jakup Krasniqit qirambajtje per 99 vite, të identifikuar në qerifikatën e pronës.

**II.** Shpallja e interesit publik bëhet me qëllim që paluajtëshmërija e përshkruar në pikën I të këtij Vendimi, të kaloj në pronësi të Komunës , pas një procedure të shpronimit apo këmbimit, për realizimin e qëllimit publik: Zgjerimi i hapsires gjelbruese te shkolles “7 shtatori” në Vitomiricë.

**III.** Prona e shpallur si interes publik në pikën I të këtij Vendimi do të shërbej ekskluzivisht për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik.

**IV.** Në bazë të këtij Vendimi, Kryetari i Komunës do të inicoj procedurat e mëtutjeshme për shpronsimin apo këmbimin e pronës në fjalë për interes publik konform dispozitave ligjore në fuqi.

**V.** Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për çështje Pronsoro-Juridike.

**VI.** Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Dr.Islam Husaj**

**Vendimi ti dërgohet:**

1x1 MAPL-së

1x1 Kryetarit të Komunës

1x1 DÇPJ

1x1 Arkivë.

